



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

---

Numri i lëndës: 2020:159322  
Datë: 29.03.2024  
Numri i dokumentit: 05524835

**CP.nr.235/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, përmes gjyqtarit individual Fuad Haliti dhe me bashkëpunëtorin profesional Eron Prekazi, në lëndën përbarimore të kreditorit H.H nga Mitrovica, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av.Gazmend Ismjali, ndaj debitorit Ndërmarrja “Trepça” Sh.A, me seli në Mitrovicë, jashtë seancës gjyqësore me datë 29.03.2024, nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**

**PËRFUNDOHET** procedura përbarimore e kreditorit H.H nga Mitrovica, ndaj debitorit Ndërmarrja “Trepça” Sh.A, me seli në Mitrovicë.

**Arsyetim**

Me aktvendimin e kësaj gjykate CP.nr.235/23 i datës 02.02.2024, është caktuar përbarimi sipas propozimit të kreditorit H.H nga Mitrovica, ndaj debitorit Ndërmarrja “Trepça” Sh.A, me seli në Mitrovicë.

Banka NLB me datën 27.03.2024, ka njoftuar gjykatën se borxhi në këtë çështje përbarimore është ekzekutuar dhe paratë janë bartur tek kreditorit.

Gjykata duke u bazuar në nenin 66 paragrafi 4 i Ligjit për Procedurën Përbarimore e përfundoj procedurën përbarimore pasi që detyrimi i debitorit ndaj kreditorit është përmbushur.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**CP.nr.235/2023, datë 29.03.2024**

**GJYQTARI**  
**Fuad Haliti**

---

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa brenda afatit 7 ditore nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.